



SIGURACIONI I PAPUNËSISË OCS

**PYETJET TUAJA,
PËRGJIGJET TONA.**

www.ocsv.ch

 **OCS**
CAISSE DE CHÔMAGE

ÇFARË DUHET BËRË NË QOFTË SE HUMB PUNËN TIME?

Në qoftë se më heqin nga puna ose kontrata ime e punës ka mbaruar.

- **Mos humbni kohë:** sa më shpejt të filloni të merrni masat e duhura, aq më parë do të përfitoni të ardhura.
- **Verifikoni nëse pushimi juaj nga puna është bërë sipas rregullave në fuqi.** Qendra jonë do t'ju ndihmojë me dëshirë që ta përcaktojë dhe në rast nevojë të ndërhyjë kundër ish punëdhënësit tuaj.
- **Kërkoni një certifikatë pune punëdhënësit tuaj. Ky është i detyruar t'ua japë,** në fund për raportin e punës tuaj.
- **Regjistrohuni në ORP** (Zyra rajonale e vendosjes) të rajonit tuaj që në momentin që merrni letrën e pushimit nga puna.
- **Zgjidhni sigurimin tuaj të papunësisë në momentin e regjistrimit në ORP:** jeni i lirë në zgjedhjen e siguracionit : ju do të bëni zgjedhjen e duhur me siguracionin e papunësisë OCS (n° 58).
- **Vihuni në kërkim të një pune të re me të marrë vesh pushimin nga puna dhe ruani si provë të gjitha përpjekjet tuaja,** në mungesë të të cilave ORP do të vonojë të drejtën tuaj për dëmshpërblimin e papunësisë.

Rroga ime nuk është derdhur më – Punëdhënësi im është në falimentim

- **Kontaktoni menjëherë siguracionin tonë të papunësisë** e cili do t'ju tregojë hapat që duhet të ndërmerri për të garantuar të drejtat tuaja.
- **Regjistrohuni në ORP** (Zyra rajonale e vendosjes) të rajonit tuaj në rast nevojë.

Jam pa punë në fund të përfundimit të shkollimit tim

- **Regjistrohuni në ORP** (Zyra rajonale e vendosjes) më të afërt prej vendbanimit tuaj.
- **Zgjidhni siguracionin tuaj të papunësisë** gjatë regjistrimit tuaj në ORP: jeni i lirë në zgjedhjen e siguracionit, ju do të bëni zgjedhjen e duhur me siguracionin e papunësisë OCS (n° 58).
- **Merrni takim me siguracionin tonë për të krijuar dosjen tuaj dhe për të përcaktuar të drejtën tuaj për dëmshpërblim.**

PËR PJEKJET E MIA ME SIGURACIONIN E PAPUNËSISË

Ju duhet të zjedhni si fillim siguracionin tuaj të papunësisë, në momentin e regjistrimit në ORP. Ne ju këshillojmë **sigurimin e papunësisë krishter social** (OCS) për shkak të rrethit të gjerë të agjencive dhe kompetencave të larta të bashkëpunëtorëve të saj.

Në rast se ju e zgjedhni OCS, agjencia që ndodhet më afër jush do t'ju ndihmojë për krijimin e dosjes suaj.

Ne kemi në dispozicion bashkëpunëtorë të aftë që mund të bisedojnë me ju në frengjisht, gjermanisht, italisht, portugalisht dhe anglisht.

Dokumentet që duhet të paraqiten për të hapur dosjen në OCS

- Kërkesa për dëshmipërbliim e plotësuar dhe e firmosur.
- Kërkesa për punë e dhënë nga ORP.
- Formulari(ët) "Attestation de l'employeur" (Vërtetim nga punëdhënësi) që përshkruan aktivitetin tuaj gjatë dy viteve të fundit, me përmbledhjen ose vërtetimin e rrogës.
- Formulari "Obligation d'entretien envers des enfants" (Detyrim për mirëmbajtjen e fëmijëve).
- Leje qëndrimi e vlefshme.
- Kontrata(t) e punës.
- Letra(t) e pushimi nga puna.
- Të dhënat bankare.

Dokumente të tjera mund të jenë të nevojshme në varësi të situatës tuaj personale e profesionale. Në rast nevojë, ne do t'ju këshillojmë e shoqërojmë në përpjekjet tuaja.

Ju mundeni njëkohësisht të ngarkoni të gjithë formularët në rrjetin tonë zyrtar të internetit www.ocsv.ch

MISIONI I SIGURACIONIT TË PAPUNËSISË OCS

Siguracioni i papunësisë OCS është në dispozicion të të gjithë personave në gjendje papunësie po ashtu edhe të ndërmarrjeve, në Valais si dhe në kantonin Vaud.

I themeluar prej Sindikatave krishtere të Valais, siguracioni i papunësisë ka për qëllim t'ju lehtësojë eksperiencën e vështirë të papunësisë, t'ju këshillojë me vend, të përcaktojë të drejtën tuaj për dëmshpërblim dhe të sigurojë derdhjen e të hollave në afatin më të mirë.

I pajisur nga një rrjet i madh agjencish, Siguracioni i papunësisë OCS ju ofron aftësinë dhe gatishmërinë e specialistëve tanë të shumtë në lëmin e të drejtës për punë dhe sigurimit të papunësisë. Kështu jeni të garantuar nga një shërbim i shpejtë, i aftë dhe afër jush.

Që nga dita e pushimit tuaj nga puna, në qoftë se dëshironi, Siguracioni ynë merret me të gjitha formalitetet e nevojshme administrative dhe ju jep këshillat e duhura.



PËR PJEKJET E MIA ME ORP

Lajmërohuni sa më shpejt të jetë e mundur në ORP (zyra rajonale e vendosjes) përkatëse, po më së fundi ditën e parë për të cilën ju kërkoni dëmshpërblim nga siguracioni i papunësisë.

Dokumentet që duhen dorëzuar gjatë regjistrimit në ORP

- Pjesa e identitetit.
- Leja e qëndrimit e vlefshme.
- Çertifikata e sigurimit AVS/AI.
- Letra e pushimit nga puna e punëdhënësit tuaj.
- Curriculum vitae (CV).
- Çertifikata e punës.
- Provat e kërkimit për punë.
- Leje për drejtim automjeti, leje të tjera të ndryshme.

MISIONI I ORP

ORP ka për qëllim kryesor, t'ju ndihmojë për të gjetur punë dhe t'ju shoqërojë në hapat tuaj për riintegrim profesional.

ORP mund t'ju ndihmojë njëkohësisht të bëni një bilanc karriere, të identifikoni aftësitë tuaja të dobishme dhe t'i vini ato në dispozicion : kurse, stazhe, mësim në një ndërmarrje etj.

ORP ka për detyrë të kontrollojë që ju nga ana juaj bëni gjithshka të mundur për të gjetur punë, nëpërmjet një formulari që duhet ta dorëzoni çdo muaj.

Ju do të mësoni më tepër gjatë ditës së informacionit në të cilën ORP do t'ju thërrasë dhe gjatë takimeve me këshilltarin tuaj në ORP.

ÇILAT JANË TË DREJTAT E MIA?

- Keni të drejtë për dëmshpërblim në qoftë se justifikoni të paktën një periudhë prej 12 muaj të kuotizacionit (përfshirë në një vend të UE- Bashkimit European ose të AELE), dhe këtë në dy vitet që i prijnë regjistrimit tuaj.
- Edhe për më pak se 12 muaj të periudhës së kuotizacionit dhe këtë në dy vitet që i prijnë regjistrimit tuaj, është e mundur në disa raste të veçanta (sëmundje, aksident, shkollim, divorc etj.) të përfitohet dëmshpërblim.
- Me t'u njohur e drejta juaj, ju përfitoni – sipas situatës suaj familjare - një sasi dëmshpërblimi prej 70% ose 80% të pagës suaj të siguruar.
- Derdhja e dëmshpërblimit të parë mundet gjithsesi me qenë pak me vonesë.
- Kohëzgjatja e të drejtës tuaj për dëmshpërblim, gjatë afatit të caktuar për dëmshpërblim varet nga aktiviteti juaj gjatë dy viteve që i prijnë regjistrimit tuaj, nga mosha juaj, nga gjendja familjare ,dhe faktorë të tjerë.

Bashkëpunëtorët e Siguracionit OCS janë në dispozicionin tuaj për t'ju informuar për të drejtat tuaja në varësi të gjendjes suaj.

Çfarë ndodh me sigurimet?

Gjatë periudhës së papunësisë, ju vazhdoni të paguani AVS/AI.

Jeni njëkohësisht i siguruar kundër rrezikut të aksidenteve dhe rrezikut të invalidit, sipas kushteve të fiksuara me ligj.

Mbajtjet legale nga rroga janë të shënuara në llogarinë tuaj mujore.

Ne ju këshillojmë me dëshirë për këto çështje.

CILAT JANË DETYRAT E MIA?

Kush flet për të drejta, flet dhe për detyra. Me qëllim që të gjeni punë dhe të jeni i dëmshpërblyer siç duhet, ju keni disa detyrime përkundrejt ORP dhe Siguracionit të Papunësisë.

Detyrimet e mia ndaj Siguracionit të Papunësisë

Siguracioni i papunësisë ju asiston, llogarit të drejtën tuaj dhe ju dëmshpërblen, e që të bëjë këtë ju duhet të dorëzoni aty dokumentet e mëposhtme:

- Formularin „Indication de la personne assurée“ (Treguesit e personit të siguruar) të këtij muaji të plotësuar dhe të firmosur (që ju e merrni nëpërmjet postës).
- Formularin „Attestation de gain intermédiaire“ (Vërtetimi i fitimeve të ndërmjetme) plotësuar nga punëdhënësi juaj, në qoftë se keni punuar gjatë muajit përkatës.
- Çertifikatë mjekësore, në qoftë se keni qenë i paaftë për punë.
- Çdo lloj tjetër justifikimi të nevojshëm për muajin përkatës (p.sh. fëmijë, masa të ndryshme për tregun e punës, stazhe, kurse, etj).

Detyrimet e mia ndaj ORP

ORP është për t'ju ndihmuar ju, po ashtu për të verifikuar nëse ju i respektoni detyrimet tuaja.. Nëse ju nuk i respektoni ato, këshilltari juaj mund të reduktojë të drejtën tuaj për dëmshpërblim. Me qëllim që kjo të mos ndodhë ju duhet:

- Të bëni gjithçka të arsyeshme që pritet prej jush, për zvogëluar ose shkurtuar kohën e papunësisë suaj.
- Kërkonit punë sipas udhëzimeve të këshilltarit tuaj në ORP.
- Ndiqni të gjitha takimet këshilluese.
- Respektoni orientimet e këshilltarit tuaj në ORP.
- Informoni ORP për të gjitha ndryshimet e gjendjes suaj të punës ose për ndonjë gjë të re.

GJITHNJË NË SHËRBIMIN TUAJ NË VALAIS E NË SHABLAIS

Bashkëpunëtorët tanë janë në shërbimin tuaj në agjenci të ndryshme për t'ju ndihmuar dhe përgjigjur pyetjeve tuaja. Ju do t'i gjeni ata:

AGJENCIA OCS SIERRE

Rue Centrale 4, 3960 Sierre (hënë-premte 9⁰⁰ - 11/30)

☎ +41 27 452 26 26 📠 +41 27 452 26 28 ✉ info.sierre@ocsv.ch

SHËRBIM I PANDËRPRERË NË

MONTANA: Bâtiment Bellavista, 3963 Montana

☎ +41 27 481 81 44 (martë 9⁰⁰ - 11⁰⁰ e enjte 14⁰⁰ - 16⁰⁰)

VISSOIE: Bureau de l'ancienne commune, 3961 Vissoie

☎ +41 79 239 10 41 (hënë 17⁰⁰ - 18⁰⁰)

LOËCHE-LES-BAINS: Immeuble Pizzeria Choucas, 3954 Loèche-les-Bains

☎ +41 27 470 26 11 (mërkurë pasdite)

SUSTEN: Fahrschule Eddy Walter, 3952 Susten

☎ +41 79 679 57 01 (mërkurë 17⁰⁰ - 18/30)

AGJENCIA OCS SION

Rue de la Porte-Neuve 20, 1950 Sion (hënë-premte 8⁰⁰- 12⁰⁰ e 13/30 - 17⁰⁰)

☎ +41 27 329 60 60 📠 +41 27 329 60 89 ✉ info.sion@ocsv.ch

AGJENCIA OCS MARTIGNY

Rue de la Poste 12, 1920 Martigny

(hënë-premte 9⁰⁰- 12⁰⁰ e 14⁰⁰ - 16⁰⁰+ shtunë paradite nga tetori në prill)

☎ +41 27 722 44 16 📠 +41 27 723 18 89 ✉ info.martigny@ocsv.ch

SHËRBIM I PANDËRPRERË NË CHÂBLE: Route de Clouchèvre 20, 1934 Le Châble
(martë e enjte ora 14⁰⁰-17⁰⁰)

☎ +41 27 722 44 16 📠 +41 27 723 19 85 ✉ info.martigny@ocsv.ch

AGJENCIA OCS MONTHEY

Place de l'Hôtel-de-Ville 9, 1870 Monthey (hënë-premte 8/30 - 12⁰⁰ e 13/30 - 16⁰⁰)

☎ +41 24 475 71 82 📠 +41 24 475 71 79 ✉ info.chablais@ocsv.ch

AGJENCIA OCS BEX

Place de l'Orme 3, 1880 Bex (martë e enjte ora 14⁰⁰-17⁰⁰)

☎ +41 24 463 50 70 📠 +41 24 463 50 73 ✉ info.chablais@ocsv.ch

ADMINISTRATION CENTRALE OCS

Place du Midi 24, 1950 Sion (hënë-premte 8⁰⁰ - 11/30 e 13/30 - 16⁰⁰)

☎ +41 27 327 34 56 📠 +41 27 327 34 59 ✉ cch@ocsv.ch

Për më shumë informacione për oraret dhe për përditësimin e informacionit:

www.ocsv.ch